



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE




MANUAL UDHËZUES

PYETËSORI I VËSHTIRËSISË NË PROCESIN E VENDIMMARRJES PËR KARRIERËN

CAREER DECISION-MAKING DIFFICULTIES QUESTIONNAIRE

Përshtatur për kontekstin shqiptar
SHTATOR, 2020



Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE SOCIALE



MANUAL UDHËZUES

PYETËSORI I VËSHTIRËSISË NË PROCESIN E VENDIMMARRJES PËR KARRIERËN

CAREER DECISION-MAKING DIFFICULTIES QUESTIONNAIRE

Përshtatur për kontekstin shqiptar
SHTATOR, 2020

Mbështetur nga:



Një projekt i Agjencisë Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC

Pyetësi i Vështirësisë në Procesin e Vendimmarrjes për karrierën - CDDQ

CDDQ-ja u mbështet në studimet e kryera në Universitetin Hebraik të Jeruzalemit nga një ekip i udhëhequr nga Itamar Gati, PhD dhe Sam Osipow. Ekipi u fokusua në studimin mbi vendimmarrjen për karrierën në përgjithësi, duke përfshirë vështirësitë që hasen gjatë marrjes së vendimeve në këtë proces, strategjitë e përdorura dhe kompromiset që bëhen, si edhe në zhvillimin e sistemeve që lehtësojnë procesin e vendimmarrjes. Ky pyetësor ka si qëllim të identifikojë vështirësitë dhe problemet e mundshme që lidhen me marrjen e vendimeve për karrierën profesionale.



Autori i CDDQ

Itamar Gati, PhD Itamar.gati@huji.ac.il



Përshtatën pyetësin CDDQ për kontekstin shqiptar si edhe përgatitën në shqip Manualin Udhëzues të CDDQ-së.

Dr. Nada Kallçiu (*Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës*)

Dr. Livia Nano (*Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës*)

Dr. Eralda Zhilla (*Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës*)



Supervizim teknik gjatë procesit të kontekstualizimit të CDDQ-së për kontekstin shqiptar

Prof. Dr. Jérôme Rossier (*Universiteti i Lozanës - UNIL*)

Ky manual është përgatitur nga Dr. Nada Kallçiu, Dr. Livia Nano, Dr. Eralda Zhilla me mbështetjen e RisiAlbania. Pikëpamjet dhe opinionet që përmbahen në të nuk përfaqësojnë ato të Qeverisë Zvicerane, as të Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC.

International Standard Book Number (ISBN) 978-9928-4564-6-5

Manuali është kataloguar pranë Bibliotekës Kombëtare të Shqipërisë



Për çdo pyetje apo informacion të mëtejshëm kontaktoni:

Dr. Nada Kallçiu: nkallciu@gmail.com

Dr. Livia Nano: livia.nano@gmail.com

Dr. Eralda Zhilla: adazhilla@gmail.com

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Supozimet dhe arsyetimi mbi modelin teorik të CDDQ-së	8
2. Taksonomia e vështirësive në procesin e vendimmarrjes për karrierën	9
3. Pikëzimi dhe interpretimi	11
4. Informacione psikometrike të CDDQ-së në Shqipëri	13
5. Përdorimet e mundshme të CDDQ-së	14
Aneksë	16
Aneksi 1: Shembull i një pyetësoi të plotësuar online	17
Aneksi 2: Pyetësoi i vështirësisë në procesin e vendimmarrjes për karrierën	20

CDDQ

VËSHIRËSITË NË PROCESIN E VENDIMARRJES PËR KARRIERËN

Qëllimi i pyetësorit “Vështirësitë në Procesin e Vendimmarrjes për Karrierën - CDDQ” është të identifikojë dhe të përqendrohet te vështirësitë me të cilat përballen individët gjatë marrjes së një vendimi për karrierën.

Ky manual ka për qëllim të sigurojë informacionet mbi taksonominë që identifikon CDDQ-ja: arsyetimin teorik dhe supozimet që rrjedhin nga CDDQ-ja, evidentimin dhe interpretimin, karakteristikat psikometrike (besueshmërinë dhe vlefshmërinë) si dhe sugjerime për përdorime të mundshme të pyetësorit. Vendimmarrja për karrierën, në gamën e vendimeve të rëndësishme në jetë është ndër më kryesoret. Marrja e vendimeve të tilla është një proces i ndërlikuar dhe një përvojë stresuese e konfuzë. Vendimet e marra nga të rinjtë mbi karrierën kanë implikime domethënëse në stilin e jetës së tyre dhe në kënaqësinë e tyre personale dhe profesionale.

Ky instrument është zhvilluar nga një taksonomi teorike e bazuar në teorinë e vendimmarrjes. Taksonomia përpiket të identifikojë disa kategori të informacioneve/njohurive e të vështirësive të vendimmarrjes në karrierë. Ajo fillon me ndarjen e vështirësive në ato që hasen përpara fillimit të procesit të vendimmarrjes dhe ato që hasen gjatë vetë procesit (Osipow, 1999).

Taksonomia e propozuar nga Prof. Gati (1996) është e mbështetur në teorinë e vendimmarrjes, e cila ka luajtur një rol të rëndësishëm në kuptimin e proceseve që përfshihen në vendimmarrjen për karrierën, që bazohet në modelin e “vendimmarrësit ideal për karrierën “ (Osipow & Gati, 1998). Një person që është i vetëdijshëm për nevojën e marrjes së një vendimi karriere, është i gatshëm ta realizojë atë dhe po ashtu është i aftë të marrë vendim “të drejtë” (p.sh. , një vendim i cili bazohet në një proces përshtatshmërie dhe është në përputhje me qëllimet dhe burimet e individit). Gati, (1996) e përcakton çdo devijim nga vendimmarrësi ideal në karrierë si një problem potencial që mund të ndikojë në procesin e vendimmarrjes së individit në një nga dy mënyrat e mundshme: (a) duke parandaluar individin që të marrë një vendim ose (b) duke çuar në një vendim më pak optimal apo më pak të drejtë. Taksonomia e propozuar prej tij (Gati et al., 1996) përfshin tri kategori kryesore të vështirësive, të cilat ndahen më tej në 10 nënkategori të veçanta të vështirësive të përcaktuara me 34 pohime specifike.

Kategoria e parë kryesore e vështirësisë, **Mungesa e Gatishmërisë** (Lack of Readiness), përfshin tre nënkategori vështirësie, të cilat i paraprijnë procesit të marrjes së një vendimi specifik për karrierën, që janë: (a) mungesa e motivimit për t'u angazhuar në procesin e vendimmarrjes për karrierën, (b) pavendosmëria e përgjithshme në lidhje me të gjitha llojet e vendimmarrjes dhe (c) bindjet jofunksionale (p.sh., pritjet e paarsyeshme (Krumboltz, 1994; Nevo, 1987; Sampson Jr., et al., 1998)

Dy kategoritë e tjera kryesore të vështirësive, **Mungesa e Informacionit** dhe **Informacione kontradiktore**, përfshijnë kategori të vështirësive që mund të lindin *gjatë procesit* të vendimmarrjes për karrierën.

Mungesa e informacionit përfshin katër nënkategori të vështirësive, që janë: (a) mungesa e njohurive për hapat që përfshihen në procesin e vendimmarrjes për karrierën, (b) mungesa e informacionit mbi veten, (c) mungesa e informacionit rreth profesioneve të ndryshme dhe (d) mungesa e informacionit rreth mënyrave të marrjes së informacionit shtesë (Gati, et al., 2000).

Kategoria e **informacioneve kontradiktore** përfshin tri nënkategori të vështirësive: (a) informacione jo të besueshme, të cilat përbëhen nga vështirësitë që lidhen me informacionin e pabesueshëm ose kontradiktor; (b) konfliktet e brendshme, që i referohen konflikteve brenda individit, siç mund të jenë edhe preferencat kontradiktore dhe (c) konfliktet e jashtme, që i referohen konflikteve që përfshijnë ndikimin e individëve të tjerë të rëndësishëm në procesin e vendimmarrjes (Gati, et al., 1996).

PROCESI I PËRSHTATJES SË INSTRUMENTIT NË KONTEKSTIN SHQIPTAR

Ky pyetësor është përshtatur në kontekstin shqiptar nga një grup ekspertësh, profesorë të Universitetit të Tiranës nën drejtimin dhe në bashkëpunim të ngushtë me ekipin e punës në Universitetin të Lozanës (UNIL), nën kujdesin e veçantë të Prof. Dr. Jerome Rossier. Procesi është kryer në bashkëpunim me autorin e instrumentit Prof. Dr. Itamar Gati.

Procesi është zhvilluar në disa faza përgjatë një periudhe një vjeçare.

Faza e parë përkton me përkthimin në gjuhën shqipe e instrumentit nga tre ekspertët e Universitetit të Tiranës, duke kaluar më pas në fazën e pilotimit në një kampion prej 20 përgjigjekthyesish ku secili ka dhënë komente specifike për pjesë të veçanta të instrumentit duke ndihmuar në rihartimin e pyetjeve specifike, pjesë e këtij instrumenti. Të gjitha komentet janë reflektuar dhe është bërë sërish përkthimi në gjuhën angleze. Grupi i ekspertëve ka komunikuar me autorin duke pasqyruar të gjitha mendimet dhe qëndrimet e përgjigjekthyesve që janë përgjigjur në fazën e parë. Pas kësaj faze është rënë dakord lidhur me pyetësorin që do të përdoret në *fazën e dytë* me një kampion prej 200 personash në qytetin e Tiranës. Grupi i ekspertëve ka bërë një shpërndarje demografike të kampionit dhe ka administruar instrumentin te 200 përgjigjekthyes. Pas analizës së të dhënave, ekspertët kanë komunikuar sërish me autorin lidhur me qëndrueshmërinë e brendshme për çdo pyetje të pyetësorit. Si fazë plotësuese është zhvilluar procesi test - ritest për një periudhë 2 javore me 100 +100 përgjigjekthyes të tjerë. Të gjitha analizat e përfutuara janë diskutuar me autorin dhe në fund të kësaj faze është finalizuar instrumenti me të gjitha pyetjet që do përdoren për *fazën e tretë* të procesit. Instrumenti, në këtë fazë është administruar në një kampion prej 1200 personash, me një shtrirje gjeografike duke përfshirë pjesën veriore, qendrore dhe jugore të vendit, përkatësisht në: Shkodër, Lezhë, Tiranë, Fier, Vlorë, Berat dhe Korçë. Grupi i ekspertëve është kujdesur që të ruajë edhe balancat gjinore dhe ndarjen sipas grupmoshave, duke përfshirë të rinj nga 14 deri në 25 vjeç në disa cikle shkollimi (klasa e nëntë, shkolla e mesme e përgjithshme dhe profesionale, universiteti në ciklin bachelor dhe master). Pas mbledhjes dhe analizës së të dhënave, në diskutim me autorin e instrumentit u ra dakord për versionin final me ndryshimet përkatëse. Në këtë manual është bashkëlidhur ky version si dhe mënyra e pikëzimit dhe e interpretimit.

Ekspertë të orientimit profesional dhe të këshillimit të karrierës do të kenë mundësi ta përdorin gjerësisht atë. *Faza e katërt* përkton me hartimin e manualit të përdorimit dhe trajnimit të profesionistëve që do ta përdorin pyetësorin në zyrat e karrieres pranë universiteteve, shkollave të mesme të përgjithshme dhe profesionale, në zyrat e pushtetit lokal si dhe të të gjithë psikologëve shkollorë.

1

SUPOZIMET DHE ARSYETIMI MBI MODELIN TEORIK TË CDDQ-SË

Marrja e vendimit për karrierën është një hap që duhet të ndërmarrin të gjithë, herë a vonë. Disa individë këtë vendim e marrin lehtë dhe pa vështirësi të dukshme, të tjerët përballen me vështirësi në marrjen e një vendimi të tillë. Për të ndihmuar këta të fundit, është e nevojshme që, së pari të lokalizohen dhe të identifikohen vështirësitë e tyre specifike.

Taksonomia e vështirësive të vendimmarrjes në karrierë, e përdorur në “Vështirësitë në Procesin e Vendimmarrjes në Karrierë” CDDQ, bazohet në teoritë e vendimmarrjes dhe përpunimit të informacionit mbi këtë proces.

Përmes CDDQ-së përcaktohet çdo devijim nga “procesi ideal” i vendimmarrjes në karrierë (d.m.th., procesi që realizohet nga vendimmarrësi ideal i karrierës), te një vështirësi që mund të çojë në pavendosmëri ose në një zgjedhje më pak optimale. Në fund të këtij manuali paraqiten edhe përdorime të mundshme të CDDQ-së në këshillim.

Hipoteza që mbështeten në taksonominë e propozuar

1. Personi “ideal” në vendimmarrjen për karrierën ka karakteristikat e tij që është:
 - i vetëdijshëm për nevojën për të marrë një vendim të tillë dhe është i gatshëm për ta marrë këtë vendim;
 - i aftë për të marrë vendimin në formën e duhur (d.m.th., duke përdorur një proces sistematik për të marrë vendimin më të arsyeshëm për qëllimet e tij / saj).
2. Çdo devijim nga “vendimmarrësi ideal” i karrierës përfshin vështirësi që mund të dëmtojnë ose pengojnë procesin e vendimmarrjes për karrierën.
3. Vështirësitë e vendimmarrjes për karrierën mund të klasifikohen në kategori të veçanta, bazuar në:
 - kur lindin vështirësitë në vendimmarrjen për karrierën (para apo gjatë angazhimit në procesin e vendimmarrjes);
 - cili është burimi i vështirësisë (konjitive apo afektive);
 - impakti i vështirësisë në vendim (bllokon procesin ose/apo çon në një vendim jo optimal);
 - sa mund të jetë koha e ndërhyrjes që kërkohet për të kapërcyer vështirësinë.
4. Pavendosmëria mund të vijë si rezultat i një vështirësie të vetme ose nga një kombinim i më shumë se një.
5. Vështirësitë e secilit individ mund të rrjedhin si nga një kategori e vetme, ashtu edhe nga kombinimi i më shumë se një.

2

TAKSONOMIA E VËSHTIRËSIVE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES PËR KARRIERËN

Gati, Krausz, & Osipow (1996)

Taksonomia e propozuar bazohet në tre nivele kategorizimi

Dallimi i parë është midis vështirësive që lindin para hyrjes në procesin e vendimmarrjes për karrierën dhe atyre që lindin gjatë procesit të vendimmarrjes. Të parat përfshijnë vështirësi që flasin për mungesën e gatishmërisë për të hyrë në procesin e vendimmarrjes për karrierën. Brenda kësaj kategorie bëhet dallimi midis: a. vështirësive që lindin nga mungesa e informacionit dhe b. vështirësive që lindin për shkak të mospërputhjes së informacionit që disponon dhe mundësisë së përdorimit të tij.

Mungesa e gatishmërisë, mungesa e informacionit dhe informacioni i paqëndrueshëm janë tre kategoritë kryesore të vështirësive në vendimmarjen për karrierën.




Fig 1. Vështirësitë e vendimmarrjes për karrierën

Më poshtë paraqitet një përshkrim i shkurtër i secilës prej kategorive specifike të vështirësive në vendimmarrje.

A: PARA SE TË NISË PROCESI I VENDIMMARRJES PËR KARRIERËN

Mungesa e gatishmërisë

Kjo kategori kryesore përbëhet nga tre nënkategori specifike vështirësish:

- **Mungesa e motivimit** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e gatishmërisë për të marrë një vendim.
- **Pavendosmëria** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron një vështirësi, indeks të përgjithshëm në marrjen e vendimeve.
- **Besime të papërshtatshme** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron një perceptim të shtrembëruar të procesit të vendimmarrjes për karrierën, pritshmëri joracionale dhe mendime jofunksionale.

B: VËSHTIRËSITË QË LINDIN, ZAKONISHT, GJATË PROCESIT TË VENDIMMARRJES PËR KARRIERËN:

1. Mungesa e informacionit

Kjo kategori kryesore përbëhet nga katër nënkategori specifike vështirësish:

- **Mungesa e informacionit në lidhje me procesin e vendimmarrjes** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e njohurive, se si mund të merret një vendim i matur. Konkretisht, mungesa e njohurive në lidhje me hapat specifikë që përfshihen në procesin e vendimmarrjes për karrierën.
- **Mungesa e informacionit mbi veten** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron situatën kur individi mendon se nuk ka informacion të mjaftueshëm për veten, si për: aftësitë, njohuritë apo parapëlqimet (p.sh., mbi parapëlqimin për karrierën, aftësitë etj).
- **Mungesa e informacionit në lidhje me profesionet** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e informacionit në lidhje me profesionet dhe mundësitë për karrierën: cilat alternativa ekzistojnë dhe / ose cilat janë karakteristikat e secilës alternativë.
- **Mungesa e informacionit në lidhje me format dhe mënyrat e marrjes së informacionit** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e informacionit në lidhje me mënyrat e marrjes së informacionit shtesë ose ndihmës që mund të lehtësojnë marrjen e vendimeve.

2. Informacione kontradiktore

Kjo kategori kryesore përbëhet nga tre nënkategori specifike vështirësish:

- **Informacion i pabesueshëm** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori tregon që individi mendon se ai / ajo ka informacione kontradiktore për veten e tij ose për profesionet e konsideruara nga ana e tij / saj.
- **Konflikte të brendshme** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron një gjendje të brendshme konfuzioni. Një konflikt i tillë i brendshëm mund të burojë nga vështirësi për të përcaktuar shumë faktorë të rëndësishëm nga pikëpamja individuale, por disa nga këto faktorë rezultojnë të papajtueshëm me njëri-tjetrin.
- **Konflikte të jashtme** - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori mund të tregojë një hendek midis parapëlqimeve të individit dhe parapëlqimeve të shprehura nga persona të tjerë të rëndësishëm për të, ose një kontradiktë midis mendimeve të dy personave të rëndësishëm për të.

3 PIKËZIMI DHE INTERPRETIMI

Pyetësi i vështirësive në procesin e vendimarrjes për karrierën (CDDQ)

Varianti i parë i CDDQ-së (Gati, Krausz dhe Osipow, 1996) përbëhet nga 44 pohime. Në përpjekje për ta bërë CDDQ-në më të thjeshtë, u ra dakord për ta shkurtuar në një version me 34 pohime, duke hequr apo zëvendësuar ato pohime që nuk dhanë rezultate në besueshmërinë e brendshme të shkallëve. Versioni përfundimtar i CDDQ-së ka 34 pohime. Secila nga dhjetë nënkategoritë e vështirësive (përshkruar më lart) përfaqësohet nga 2 deri në 5 pohime. Për më tepër, CDDQ-ja përfshin edhe dy pohime për të testuar vlefshmërinë e instrumentit.

Vlerësimi i CDDQ-së (34 pohime)

Shkalla	Vlera mesatare e pohimeve
Gatishmëria	
Rm-Mungesa e motivimit	1-3
Ri-Pavendosmëria	4-6
Rd-Besime të papërshtatshme	8-11
Mungesa e informacionit	
Lp-Procesi vendimmarrjes	13-15
Ls-Vetja/Uni	16-19
Lo-Profesionet	20-22
La-Format e marrjes së informacionit shtesë	23-24
Vështirësitë në lidhje me informacione kontradiktore	
Lu- Informacion i pabesueshëm	25-27
Li- Konflike të brendshme	28-32
Le- Konflike të jashtme	33-34

Rezultatet e pyetësit CDDQ llogariten si mesatare e pohimeve që janë përfshirë në çdo njëren nga kategoritë dhe nënkategoritë.

Shënim: Pohimet 7 dhe 12 janë dy pohime për të testuar vlefshmërinë e instrumentit. (Pohimi nr. 7 pritet të jetë me vlerë > 4; Pohimi nr. 12 pritet të jetë me vlerë <5)

Grupimet sipas vështirësive:

Gatishmëria	$(R_m + R_i + R_d) / 3$
Mungesa e informacionit	$(L_p + L_s + L_o + L_a) / 4$
Informacione kontradiktore	$(L_u + L_i + L_e) / 3$

Rezultati total i CDDQ-së:

Mesatarja e dhjetë nënkategorive - $(R_m + R_i + R_d + L_p + L_s + L_o + L_a + L_u + L_i + L_e) / 10$

Interpretimi:

Rezultati nga

6.34 e lart

konsiderohet një kategori vështirësish “rilevante apo e rëndësishme”

Rezultati me vlerë nga

3.33 në 6.34

konsiderohet si kategori vështirësish “të moderuara”

Rezultati

më i ulët se 3.33

konsiderohet një kategori vështirësish “e papërfillshme”

4 INFORMACIONE PSIKOMETRIKE TË CDDQ-SË NË SHQIPËRI

Rregulli i thjeshtë në interpretimin e CDDQ, kur në një kategori na shfaqet:

Karakteristikat psikometrike të CDDQ-së në Shqipëri

Qëndrueshmëria e brendshme e shkallëve të CDDQ-së, me të dhënat e mbledhura në Shqipëri						
Kampioni			Cronbach α Besueshmëria			
Grupi	Mosha	Nr.	Mungesa e gatishmërisë	Mungesa e informacionit	Informacione kontradiktore	Total CDDQ
Të rinj nga Shqipëria	14-22	1249	0.61	0.9	0.84	0.91

Besueshmëria e CDDQ (Cronbach α Vlerësimi i Qëndrueshmërisë së Brendshme)

Test - Retest Vlerësimi						
Kampioni			Test - Retest Besueshmëria			
Grupi	Mosha	Nr.	Mungesa e gatishmërisë	Mungesa e informacionit	Informacione kontradiktore	Total CDDQ
Të rinj nga Shqipëria	14-22	100	0.77	0.73	0.68	0.81

5

PËRDORIMET E MUNDSHME TË CDDQ-SË

Cituar nga: Tina Sirois-LeBlanc & Jeffrey Landine,
Universiteti i New Brunswick

Shërbimi i Këshillimit të Karrierës

“ CDDQ-ja, identifikon dhe merr në konsideratë detyrat kryesore të zhvillimit të vendimmarrjes për karrierën ”

- I. **Ekzaminimi fillestar i klientit** - kontrolli sipas 3 kategorive kryesore ose 10 nënkategorive të vështirësisë dhe drejtimi i tyre në opsionet përkatëse të ndërhyrjes.
- II. **Diagnostifikimi i vështirësive të një klienti** - krijimi i sigurisë që këshilluesi i karrierës, në intervistën ballë për ballë ka të dhënat e duhura fillestare lidhur me fokusin e vështirësive të klientit, në mënyrë që seanca e parë e këshillimit të fillojë me një analizë të rezultateve të CDDQ-së.
- III. **Vlerësimi i nevojave** - mbledhja e informacionit në lidhje me llojet e vështirësive që hasen shpesh nga grupe të veçanta, si p.sh. nxënës të shkollave të mesme, burra, gra, grupe të veçanta të pakicave etj. (Gati & Saka, 2001)
- IV. **Vlerësimi i ndërhyrjeve** - vlerësimi i efektivitetit të ndërhyrjes, si p.sh. krahasimi i situatave para dhe pas ndërhyrjes. (Gati, Saka & Krausz, 2001; Fouad, Cotter, & Kantamneni, 2009)

Pyetje të shpeshta mbi CDDQ-në

Pyetje 1: Cili është ndryshimi midis versionit të parë me 44-pohime dhe atij final me 34-pohime?

Përgjigje: CDDQ-ja në variantin origjinal (Gati, Krausz dhe Osipow, 1996) përbëhej nga 44 pohime. Në përpjekje për ta bërë CDDQ-në më të arritshme dhe më të thjeshtë, është kaluar në formën finale me 34 pohime duke hequr ato pohime që nuk kontribuan ndjeshëm në rezultatet e tij. Gjithashtu, rekomandojmë ta përdorni versionin bashkëngjitur si shtojca 2, me 34 pohime, në variant të printuar, për të lehtësuar procesin e plotësimit të përgjigjeve.

Pyetje 2: A mund të përdoret CDDQ-ja për të demonstruar efektivitetin e shërbimeve të këshillimit për karrierë?

Përgjigje: Administroni CDDQ-në para dhe pas ndërhyrjeve përkatëse të këshillimit (për shembull, konsultoni Fouad, Cotter, & Kantamneni, 2009; Gati, Krausz dhe Saka, 2001) për të shqyrtuar ndryshimet në rezultatit e përgjithshëm dhe në rezultatet e kategorive specifike të vështirësisë, si rezultat i ndërhyrjes tuaj.

Pyetje 3: Cili është avantazhi i përdorimit të CDDQ-së për vlerësimin e rezultateve të këshillimit në karrierë ose/apo ndërhyrjeve të tjera?

Përgjigje: Për shkak të natyrës shumëdimensionale të CDDQ-së (profili bazë me 10-të nënkategori të vështirësive), efektiviteti i ndërhyrjes është i dukshëm dhe kështu mund të vlerësohet lehtësisht mënyra e saktë me të cilën ndërhyrja ka ndihmuar klientin. Kjo do të ishte

më e vështirë dhe madje e pamundur të vlerësohej me një instrument një-dimENSIONAL (p.sh., CDS; Osipow, Carney, & Barak, 1976).

Pyetje 4: Si mund të interpretohen përgjigjet e një klienti me anë të CDDQ-së? Çfarë duhet të konsiderohet vështirësi e dukshme? Çfarë duhet të konsiderohet e moderuar apo e papërfillshme?

Përgjigje: Rregulli i thjeshtë është që një kategori vështirësish me një përgjigje mesatare nga 6.34 e më lart është “e dukshme”; nën 3.34 është “e papërfillshme” dhe rezultatet në mes janë “të moderuara”. Është zhvilluar edhe një procedurë më gjithëpërfshirëse e interpretimit, bazuar në kujdesin relativ të vështirësive të individit, të vlerësuara si të vlefshme nga gjykimet e ekspertëve për këshillimin për karrierën. Versioni në internet i CDDQ-së ka një procedurë automatike të pikëzimit dhe profilet e klientëve interpretohen sipas kësaj metode. Edhe raporti interpretues nxjerr në pah fokusin e vështirësive në marrjen e vendimeve për karrierën të klientëve (sipas shtojcës A).

Pyetje 5: Si mund ta përdor CDDQ-në për të ofruar një shërbim më të mirë për klientët e mi?

Përgjigje: CDDQ-ja u mundëson përdoruesve të gjejnë fokusin specifik të vështirësive në marrjen e vendimeve për karrierën të klientit dhe kështu i lejon këshilluesit e karrierës të hartojë një plan pune i cili adreson nevojat specifike të çdo klienti. Ekzistojnë qendra të këshillimit për karrierën që tashmë e kanë përfshirë me sukses CDDQ-në mes instrumentave të përdorura për të përmirësuar shërbimet e tyre.

CDDQ-ja ofron informacione mbi fokusin specifik të vështirësive në marrjen e vendimeve për karrierën të një klienti, si dhe një rezultat të përgjithshëm të nivelit të vështirësive.

Shembuj pohimesh nga CDDQ-ja

1. Zakonisht unë e kam të vështirë të marr vendime.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
34. E kam të vështirë të marr një vendim për karrierën sepse kam informacione kontradiktore nga njerëz të rëndësishëm për mua në lidhje me karrierën që më përshkruan apo kriteret që duhet të merrja në konsideratë për të bërë zgjedhjen time.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
18. E kam të vështirë të marr një vendim për karrierën sepse nuk kam mjaft informacion rreth aftësive të mia (për shembull, aftësitë numerike, aftësitë verbale) dhe/ose rreth tipareve të personalitetit tim (për shembull, këmbëngulja, iniciativa, durimi).										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
33. E kam të vështirë të marr një vendim për karrierën time pasi njerëzit më të rëndësishëm për mua (si prindërit dhe miqtë) nuk janë dakord me profesionin që po marr në konsideratë.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mire

* Instrumenti i plotë gjendet si aneks II i këtij manuali

Duke u mbështetur në përgjigjet e dhëna në pyetësorin e plotësuar online, po paraqesim një përmbledhje të vështirësive në procesin e vendimmarrjes për karrierën.





Së pari, do të prezantohen kategoritë ku përgjigjet reflektojnë vështirësi të dukshme. Më pas, kategoritë në të cilat përgjigjet reflektojnë vështirësi të moderuara dhe, së fundi, do të paraqesim rekomandimet e autorëve lidhur me hapat që këshilluesi mund të ndërmarrë për të adresuar këto vështirësi.


ANEKSE








ANEKS I

SHEMBULL I NJË PYETËSORI TË PLOTËSUAR ONLINE

Lloji i vështirësive Përgjigjet pasqyrojnë vështirësi të larta dhe të rëndësishme që përfshijnë:	Rezultati	
Pavendosmëria - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron një gjendje të përgjithshme me vështirësi në marrjen e vendimeve për karrierën. Shumë njerëz kanë prirje të jenë të pavendosur në fusha të ndryshme të jetës. Vendimet shpesh shoqërohen me hezitim dhe frikë nga dështimi ose/apo angazhimi. Njerëzit që janë përgjithësisht të pavendosur mund të marrin më shumë kohë ose të ndryshojnë mendim në mënyrë të përsëritur pasi ta kenë marrë një vendim. Ndonjëherë, ata mund të ndiejnë se kanë nevojë që të tjerët të bien dakord me vendimin e tyre në mënyrë që të kenë sigurinë se kanë bërë zgjedhjen e duhur.	6	
Besime të papërshtatshme i referohet besimeve, situatave dhe pritshmërive joracionale të vendimmarrjes për karrierën. Një rezultat i lartë në këtë shkallë pasqyron një perceptim të shtrembëruar dhe jo të saktë, të procesit të vendimmarrjes në karrierë. Besimet joracionale në lidhje me vendimet për karrierën, siç është besimi se zgjedhja e karrierës është domosdoshmërisht një angazhim për gjatë gjithë jetës, apo se një profesion mund të përmbushë të gjitha aspiratat e individit, mund të pengojë procesin e vendimmarrjes për karrierën.	6.5	
Mungesa e informacionit në lidhje me procesin e vendimmarrjes - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e njohurive se si mund të merrni vendimin e duhur dhe, konkretisht, se cilat janë hapat që duhen ndërmarrë dhe që përfshihen në këtë proces. Për shembull, nuk keni njohuri se çfarë faktorësh duhet të merren në konsideratë, ose çfarë vështirësish hasen në ndërthurjen e njohurive për veten (për shembull, pikat e forta dhe të dobëta) me informacione mbi mundësitë e ndryshme për karrierën (për shembull, cilat aftësi kërkohen për një profesion specifik pune apo çfarë njohurish kërkon një profesion).	6.7	
Mungesa e informacionit në lidhje me profesionet - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e informacionit në lidhje me profesionet ekzistuese: cilat alternativa ekzistojnë dhe / ose çfarë përfaqëson secila prej alternativave.	6.7	

Lloji i vështirësive Përgjigjet pasqyrojnë vështirësi të moderuara që përfshijnë:	Rezultati	
Mungesa e informacionit për veten - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron një situatë kur individ i mendon se nuk ka mjaftueshëm informacion për veten. Mund të mos e dini se çfarë dëshironi - për shembull, cilat kushte pune preferoni, ose nëse keni mjaft aftësi apo jeni të talentuar në një fushë të caktuar, ose nëse keni tipare të personalitetit që janë kritike për një profesion të caktuar.	4	

<p>Mungesa e informacionit nga burime të tjera plotësuese - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e informacionit në lidhje me mënyrat e marrjes së informacioneve plotësuese ose ndihmë që mund të lehtësojnë marrjen e vendimeve. Për shembull, ju mund të mos dini se ku të kërkonti informacione rreth profesioneve, ose ku janë zyrat e këshillimit dhe si të aksesoni për të marrë këtë shërbim.</p>	4	
<p>Informacion i pabesueshëm - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori tregon se ju mendoni se informacioni që keni për veten ose për profesionet që pëlqeni ka kontradikta. Për shembull, mund të ketë kontradikta midis mënyrës se si e shihni veten dhe mënyrës se si ju shikojnë të tjerët, ose midis informacionit subjektiv dhe atij objektiv për veten (për shembull, nëse ju komunikohet nga mësuesi i pikturës se punimet tuaja janë të shkëlqyera, por ju konsideroni ato të thjeshta e mediokre)</p>	4.7	
<p>Konflikte të brendshme - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron një gjendje konfuzioni të brendshëm. Një konflikt i tillë mund të burojë nga vështirësi në gjetjen e kompromisit midis shumë faktorëve që i konsideroni si të rëndësishëm (për shembull, jeni pranuar në një universitet, por partneri juaj jeton në një qytet tjetër). Konfliktet e brendshme mund të shfaqen edhe kur një profesion tërheqës përfshin një element të caktuar jo tërheqës (siç janë studimet e gjata që nevojiten për t'u bërë mjek), ose kur disa profesione duken po aq tërheqëse.</p>	4.4	

Lloji i vështirësive	Rezultati	
Përgjigjet pasqyrojnë që nuk keni vështirësi të dukshme dhe përfshijnë:		
<p>Mungesa e motivimit - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori pasqyron mungesën e gatishmërisë dhe motivimit për të marrë një vendim në këtë moment. Kjo mund të tregojë që ju nuk jeni gati të merrni një vendim tani, ose mund të burojë nga një besim se nuk ka nevojë për të investuar kohë dhe përpjekje duke u munduar të bëni një zgjedhje për karrierën, pasi koha do t'ju çojë në vendimin e duhur.</p>	2.3	
<p>Konfliktet e jashtme - Një rezultat i lartë në këtë nënkategori mund të tregojë një hendek midis parapëlqimeve tuaja dhe parapëlqimeve të shprehura nga persona të tjerë të rëndësishëm. Konfliktet e jashtme lindin kur ju vendosni të merrni parasysh një faktor të caktuar ose të zgjidhni një profesion të caktuar, ndërsa persona të tjerë të rëndësishëm kanë parapëlqime të ndryshme. Për shembull, ju mund të preferoni një profesion që kërkon një program të shkurtër shkollimi, ndërsa prindërit tuaj preferojnë që ju të zgjidhni një karrierë akademike të plotë.</p>	2.5	

REKOMANDIME:

Rekomandojmë të bashkëpunoni me ekspertë të fushës së këshillimit për karrierën, ekspertë të cilët mund t'ju ofrojnë përgjigje në disa nga çështjet dhe paqartësitë tuaja në lidhje me parapëlqimet dhe aftësitë duke përdorur teste profesionale gjatë intervistave. Ekspertët do t'ju ndihmojnë edhe në marrjen e vendimeve në përgjithësi dhe do t'ju ndihmojnë të zgjidhni konfliktet tuaja në lidhje me vendimmarrjen për karrierën.

Më poshtë janë disa rekomandime të përgjithshme në lidhje me burimet e informacionit që mund t'ju ndihmojnë në procesin e vendimmarrjes, në:

- Besimet jo koherente
- Mungesën e informacionit në lidhje me procesin e vendimmarrjes
- Mungesën e informacionit mbi profesionet
- Mungesën e informacionit në lidhje me marrjen e informacionit
- Informacionin e pabesueshëm

Këshillimi për karrierën përfshin biseda "sy më sy" me një ekspert të fushës, por edhe instrumentat ju ndihmojnë të njiheni me aftësitë, parapëlqimet dhe përshtatjen me profesionet e ndryshme. Në zyrat e këshillimit mund të gjeni edhe materiale të ndryshme informuese dhe udhëzues mbi mundësitë e punësimit dhe formimit profesional.

Për të adresuar vështirësinë në vendimmarrje, ju rekomandojmë në mënyrë të veçantë të drejtoheni tek ekspertët e këshillimit të karrierës. Nëse nuk keni mundësi, mund të jetë i dobishëm modeli online (http://kivunim.huji.ac.il/cddq/pic2_g.htm). Ky model ju drejton, përmes një procesi sistematik e të strukturuar të vendimeve dhe do t'ju ndihmojë në vendimmarrjen tuaj.

Këshilluesi i karrierës mund t'ju ndihmojë të mbani ose të ndryshoni mendimet dhe mosbesimet tuaja të paqëndrueshme, të cilat ndoshta pengojnë procesin tuaj të vendimmarrjes.

Për të mbledhur informacion në lidhje me procesin e vendimmarrjes, ju rekomandojmë të vizitoni faqen web: http://kivunim.huji.ac.il/cddq/pic2_g.htm dhe të mësoni për modelin PIC dhe tre fazat e rekomanduara të procesit të vendimmarrjes për karrierën. Mund të vizitoni edhe faqen e MBCD, <http://mbcd.intocareers.org/> që do t'ju orientojë hap pas hapi përmes procesit të krijimit të një liste të shkurtër të profesioneve që përputhen me parapëlqimet dhe kriteret tuaja.

Për të marrë informacione rreth "vetes", ju mund të: 1) vizitoni faqen e MBCD, <http://mbcd.intocareers.org/> që do t'ju ndihmojë të kristalizoni parapëlqimet tuaja profesionale dhe mund t'i drejtoheni një këshilluesi karriere që do t'ju ndihmojë të vlerësoni aftësitë tuaja profesionale.

Meqenëse profesionet ndryshojnë në karakteristikat e tyre nga një vend në tjetrin, rekomandohet të kërkoni informacione mbi profesionet në faqet e internetit të vendit ku jetoni. Gjithashtu mund të vizitoni vendet e punës të profesioneve përkatëse për të marrë informacione profesionale më specifike. Informacioni i marrë nga vëzhgimi në terren është unik dhe shumë i dobishëm.

ANEKS I I

PYETËSORI I VËSHTIRËSISË NË PROCESIN E VENDIMARRJES PËR KARRIERËN

Ky pyetësor ka si qëllim të identifikojë vështirësitë dhe problemet e mundshme në lidhje me marrjen e vendimeve për karrierën profesionale. Ju lutem filloni të plotësoni informacionin e mëposhtëm:

TË DHËNAT DEMOGRAFIKE

Gjinia F M

Mosha

Numri i viteve të shkollimit të kryera deri tani: _____

Vendlindja _____

Vendbanimi _____

Niveli arsimor i prindërve:

Nëna

I ulët

I mesëm

I lartë

Babai

I ulët

I mesëm

I lartë

Keni menduar ndonjëherë në cilën fushë do t'ju pëlqente të studionit apo çfarë profesioni do të dëshironit të zgjidhnit në të ardhmen?

PO

JO

Nëse **PO**, sa të sigurt jeni në zgjedhjen tuaj?

Aspak të sigurt	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Shumë të sigurt
-----------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	-----------------

Më poshtë ju do të lexoni një listë pohimesh që lidhen me procesin e vendimarrjes në karrierë. Ju lutem, përcaktoni në shkallën më poshtë, duke zgjedhur numrin, që reflekton më mirë mendimin tuaj.

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

Rrethoni 1 nëse pohimi nuk ju përshkruan dhe 9 nëse ju përshkruan mirë. Sigurisht, mund ta rrethoni secilin nga numrat e tjerë. Ju lutemi mos lini pa plotësuar asnjë pohim.

1. E di që më duhet të zgjedh/vendos për karrierën time profesionale, por thjesht nuk e kam motivimin për ta marrë këtë vendim tani.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

2. Puna nuk është gjëja më me rëndësi në jetën e njeriut dhe, rrjedhimisht, çështja e zgjedhjes së karrierës profesionale nuk më shqetëson edhe aq shumë.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

3. Besoj se nuk më duhet ta zgjedh tani karrierën profesionale, sepse vetë koha do të më udhëheqë në zgjedhjen e karrierës “së duhur”.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

4. Zakonisht, unë e kam të vështirë të marr vendime.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

5. Zakonisht, ndiej se kam nevojë për konfirmim dhe mbështetje nga një profesionist i fushës ose nga dikush që i besoj kur më duhet të marr vendime.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

6. Zakonisht kam frikë nga dështimi.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

7. Pëlqej t'i bëj gjërat në mënyrën time.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

8. Pres që fillimi i karrierës që do zgjedh do t'i zgjidhë edhe problemet e mia personale.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

9. Besoj se ka vetëm një profesion që më përshtatet.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

10. Besoj se përmes karrierës profesionale që do zgjedh do t'i përmbush të gjitha aspiratat e mia.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

11. Besoj se zgjedhja e karrierës profesionale është zgjedhje që bëhet një herë dhe është e përvetshme.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

12. Gjithmonë bëj atë që më duhet, edhe nëse është kundër vullnetit tim.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

13. E kam të vështirë të marr vendimin e karrierës profesionale, sepse nuk e di cilat hapa duhet të ndërmarr.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

14. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën profesionale sepse nuk e di çfarë faktorësh të marrë në konsideratë.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

15. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën profesionale sepse nuk e di si të kombinoj informacionin që kam për veten me informacionin që e kam rreth karrierave të profesioneve të ndryshme.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

16. E kam të vështirë të marr një vendim për karrierën ,sepse ende nuk e di cilat profesione më interesojnë.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

17. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse nuk jam ende i/e sigurt rreth parapëlqimeve të mija mbi karrierën (për shembull, çfarë marrëdhënies dua të kem me njerëzit, çfarë mjedisi pune parapëlqej).										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

18. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse nuk kam mjaft informacion rreth aftësive të mia (për shembull, aftësitë numerike, aftësitë verbale) dhe/ose rreth tipareve të personalitetit tim (për shembull, këmbëngulja, iniciativa, durimi).										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

19. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën profesionale, sepse nuk e di si do të jenë aftësitë dhe/ose tiparet e personalitetit tim në të ardhmen.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

20. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën profesionale, sepse nuk kam informacionin e nevojshëm rreth larmishmërisë së profesioneve apo programeve të studimit/trajnitimit që ekzistojnë.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

21. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse nuk kam mjaft informacion rreth karakteristikave të profesioneve dhe/ose programeve të studimit/trajnitimit që më interesojnë (për shembull, kërkesa e tregut, të ardhurat, mundësitë e avancimit në karrierë apo parakushtet e programit të shkollimit/trajnitimit).										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

22. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën ,sepse nuk e di se si do të jenë profesionet në të ardhmen.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

23. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse nuk e di si t'i siguroj informacionet shtesë rreth vetes sime (për shembull, rreth aftësive apo tipareve të personalitetit tim).										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

24. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse nuk e di si t'i siguroj informacione e sakta dhe të përditësuara rreth profesioneve dhe programeve ekzistuese të shkollimit/trajnitimit dhe karakteristikave të tyre.										
Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë

25. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse vazhdimisht i ndryshoj parapëlqimet e mia mbi karrierën (për shembull, nganjëherë dua të jem i/e vetëpunësuar dhe nganjëherë dua të jem i punësuar diku).

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

26. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse kam të dhëna kontradiktore rreth aftësive dhe ose/tipareve të personalitetit tim (për shembull, besoj se jam i durueshëm/ e durueshme me të tjerët, por të tjerët thonë se nuk kam durim).

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

27. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse kam të dhëna kontradiktore rreth ekzistencës apo karakteristikave të një profesioni apo programi shkollimi/ trajnimi të veçantë.

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

28. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse jam njësoj i/e tërhequr nga një numër profesione dhe e kam të vështirë të zgjedh midis tyre.

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

29. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse nuk më pëlqen asnjë profesion apo program shkollimi/trajnimi në të cilin mund të pranohem.

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

30. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse profesioni në të cilin jam i/e interesuar përfshin disa karakteristika që më shqetësojnë (për shembull, jam i/e interesuar për mjekësinë, por nuk dua të studioj shumë vite).

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

31. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse parapëlqimet e mia nuk mund të kombinohen në një karrierë të vetme profesionale dhe nuk dua të heq dorë nga asnjëra prej tyre (për shembull, do të doja të punoja si ekspert i pavarur, por dua të kem edhe të ardhura të qëndrueshme).

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

32. E kam të vështirë ta marr vendimin për karrierën, sepse aftësitë dhe shkathhtësitë e mia nuk përputhen me ato që kërkohen nga profesioni për të cilin jam i/e interesuar.

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

33. E kam të vështirë të marr një vendim për karrierën time, pasi njerëzit më të rëndësishëm për mua (si prindërit dhe miqtë) nuk janë dakord me profesionin që po marr në konsideratë.

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

34. E kam të vështirë të marr një vendim për karrierën sepse kam informacione kontradiktore nga njerëz të rëndësishëm për mua në lidhje me karrierën që më përshkruan apo kriteret që duhet të merrja në konsideratë për të bërë zgjedhjen time.

Nuk më përshkruan	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Më përshkruan mirë
-------------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	--------------------

Përfundimisht, si do ta vlerësonit shkallën tuaj të vështirësisë në marrjen e vendimit për zgjedhjen e karrierës?

Të ulët	1	2	3	4	5	6	7	8	9	Të lartë
---------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	----------

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Gati, Itamar

Pyetësoni i vështirësisë në procesin e vendimmarrjes për karrierën :
manual udhëzues / Itamar Gati ; përshtat. në shqip. Nada Kallçiu, Livia Nano, Eralda Zhilla.
Tiranë : Dollonja, 2020

... f. ; ... cm.

Tit. origj.: Career decision-making difficulties questionnaire
ISBN 978-9928-4564-6-5

1.Profesionj; 2.Orientimi; 3.Pyetje dhe përgjigje; 4.Manuale
331.548 (035)

ISBN 978-9928-4564-6-5



9 789928 456465